REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA

Ne baze te nenit 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja (d) të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, publikuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", e në mbështetje të nenit 24, të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, publikuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019" dhe nenit 29, të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, e konform nenit 15, 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, e në zbatim të kërkesës për rishqyrtimin e aktit të lëshuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Nr. 020-431/6 të datës 07.08.2026, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën ----------, miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M
Për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik

Neni 1

Me këtë vendim shpallen interes i përgjithshëm publikë pronat private të cekura më poshtë;

1.1. Parcela kadastrale **P-72116046-02670-8** sipas certifikatës së pronës Nr.11-463-936/2026 e datës 12.06.2026, me sipërfaqe të përgjithshme prej **282m²** zona kadastrale Suharekë, vendi i quajtur "Shiroko" e evidentuar në emër të Ben Center SH.P.K me seli në Suharekë dhe

1.2. Parcela kadastrale **P-72116046-02670-10** sipas certifikatës së pronës Nr. Nr.11-463-936/2026 e datës 12.06.2026, me sipërfaqe të përgjithshme prej **571m²** zona kadastrale Suharekë, vendi i quajtur "Shiroko" e evidentuar në emër të Ben Center SH.P.K me seli në Suharekë.

1.3. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të pronës të lartë cekura është "**Ndërtimi dhe zgjerimi i unazës që lidhë rrugën Suharekë-Prizren, rrugën Suharekë-Rahovec dhe kyqja për Autostrad"**.

Neni 2

Obligohet Kryetari i Komunës që komform dispozitave ligjore të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës dhe të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, të inicon procedurate e këmbimit të pronës publike me persona fizik dhe juridik për sigurimin e pronës për përmbushjen e qëllimit të interesit publik.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorinë për shërbime pronësore juridike dhe kadaster në Komunën e Suharekës.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, (QRK) Nr. 03/2026, për procedurat e shqyrtimit administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen zyrtare të Komunës.

K U V E N D I K O M U N Ë S N Ë S U H A R E K Ë

01-Nr-_____
Me datë_____

Kryesuesi Kuvendit
_____
Mr.ec Bexhet KUÇI